



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FUSHË-ARRËZ

KËSHILLI

Nr 2072 prot.

Fushë-Arrëz, me 28.06 2024

VENDIM

Nr. 27. Datë. 27.06.2024

PËR

MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR I BLOK-NDIHMËS EKONOMIKE I 6% PËR MUAJIN MAJ 2024 PËR NJËSITË ADMINISTRATIVE : FUSHË-ARRËZ, IBALLE, FIERZE , QAFË-MALI DHE BLERIM.

Në zbatim të ligjit 139/215 "Për vetëqeverisjen vendore:" .i ndryshuar, neni 24, ligjit nr, 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", VKM nr.597.datë 14.09.2019 " Për përcaktimin e procedurave. të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe të përdorimit të fondit shtesë, mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", VKM nr.85.datë 10.02.2021 "Për një shtesë në vendimin nr.597. datë 4.9.2019 të Këshillit të Ministrave" Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike,dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", Udhëzimit të Ministrisë së Mireqënies Sociale dhe Rinisë nr .5. datë 17.02.2017 "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri ne 6%", i ndryshuar , VKM nr.868. datë 29.12. 2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr 597.datë . 4,9.2019 të Këshillit të Ministrave" Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe të përdorimit të fondit shtesë mbi fondet e kushtëzuara për ndihmën ekonomike", VKB nr. datë 30.01.2024 "Për miratimin e kriterëve të dhënjes së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% për vitin 2024,", VKM nr.159. datë 12,03.2022 "Për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta për zbutjen e pasojave të ndikuara nga lufta në Ukrainë" , Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e tij të datës 27.06.2024, pas shqyrtimit të propozimeve të paraqitura nga administratorët e ndihmës ekonomike të Bashkisë Fushë-Arrëz:

VENDOSI:

Të miratojë listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike i 6 % për muajin Maj 2024 për 34 familje me një fond 135,722 lekë nga shuma prej 138,137 lekë, që rrjedh nga fondi total i ndihmës ekonomike prej 2,302,284 lekë, pra shuma që do të

shpërndahet për përfituesit është 135.722, lekë , sipas njësive administrative për muajin Maj 2024 dhe konkretisht:

NJËSIA ADMINISTRATIVE QENDËR FUSHË-ARRËZ

Përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike i 6% për muajin Maj 2024 16 familje me një fond 56.,601 lekë.

NJËSIA ADMINISTRATIVE IBALLË

Përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike i 6% për muajin Maj 2024 6 familje me një fond 25,028 lekë.

NJËSIA ADMINISTRATIVE FIERZË

Përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike i 6% për muajin Maj 2024 gjithsejt 2 familje me një fond prej 6,752 lekë.

NJËSIA ADMINISTRATIVE QAFË-MALI

Përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë nga fondi i kushtëzuar i bllok -ndihmës ekonomike i 6% për muajin Maj 2024 gjithsej 6 familje me një fond 29.760 lekë.

NJËSIA ADMINISTRATIVE BLERIM

Përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike i 6% për muajin Maj 2024 gjithsej 4 familje me një fond 17,581 lekë.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata e Bashkisë!

Miratuar me 8 vota pro

Vota kundër 0 vota

Vota abstenim 0 vota

Ky vendim u shpall me datë 28 .06.2024.

SEKRETARI

Tom CURRI



KRYETARI

Nikolin BARDHOKU

